

## **TEKNIKAT DHE GJUHËT E PROGRAMIMIT**

Kodi i lëndës	Semestri	Kreditet e lëndës				Kredite
		Leksione	Ushtrime/ Seminare	Laboratore	Detyra	
B-TLK-111	II	3	2	0.5	0.5	6
<b>Sasia e orëve: auditor/jashtë auditorit</b>		<b>36/39</b>	<b>28/22</b>	<b>10/2.5</b>	<b>2.5/10</b>	<b>76.5/73.5</b>
<b>Sasia e orëve: Total</b>		<b>75</b>	<b>50</b>	<b>12.5</b>	<b>12.5</b>	<b>150</b>

**Titullari i lëndës: Enida Sheme, Doktor**

### **Objektivat e lëndës**

Programi është bazuar në një literaturë bashkëkohore dhe në ndërthurjen e leksioneve me seminarët, punët laboratorike dhe detyrat e kursit. Ka si objektiv përgatitjen e studenteve me njohuri bazë mbi mënyrat e programimit dhe ndërtimit e aplikimeve në gjuhën e programimit C.

### **Programi i lëndës**

Hyrje në programim, IDE dhe përdorimi i tyre. Ndërtimi i një aplikimi në C. Komentet dhe përdorimi i tyre. Kompilimi dhe ekzekutimi i një programi në gjuhën C. Çfarë janë variablat. Variablat numerike të plota. Variablat Floating-Point. Përcaktimi i variablave si unsigned dhe signed. Çfarë janë operatorët. Përdorimi i tyre. Prioriteti i operatorëve. Kushtet llogjike. Operatori switch case. Ciklet dhe përdorimi i tyre. Cikli For. Cikli WHILE dhe Do – While. Përdorimi i funksionit printf dhe parametrat e tij. Përdorimi i funksionit scanf. Kombinimi i tyre dhe përdorimi. Deklarimi i pointerave. Përdorimi i adresave. Alokimi dhe dealokimi i memorieve. Përdorimi i pointerave të llojit Char si string. Deklarimet e vektorëve një dimensional. Aksesimi i vektorëve dhe përdorimi i indekseve. Vektorët dy dimensionalë. Vektorët shumë dimensionalë. Ndërtimi i funksioneve. Parametrizimi. Përdorimi i funksioneve. Funksionet rekursiv. Stringat. Deklarimet si vektor. Deklarimet si pointer. Përdorimi i funksioneve të librarisë string.h. Strukturat dhe Unionet. Deklarimet e strukturave. Përdorimi i strukturave. Alokimi në memorje. Çfarë janë skedarët. Skedarët tekst. Skedarët binar. Përdorimi i funksioneve për lexim dhe shkrim. Ndërfaqja grafike. Përdorimi i librarive të gatshme.

### **Literatura e rekomanduar për lëndën**

Gjuha C për Inxhinierinë, 2009;

Ivor Horton. *Beginning C, From Novice to Professional, Fourth Edition*, 2004;

D. Ritchie, *C Programming Language (2nd Edition)*, 1988;